

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hetimet/ Shpërthimi që shkaktoi 6 viktima në Athinë, çifti shqiptar në pritje të fëmijës, autoritetet dyshojnë për rrjedhje gazi
ADRESA	https://tpz.al/hetimet-shperthimi-qe-shkaktoi-6-viktima-ne-athine-cifti-shqiptar-ne-pritje-te-femijes-autoritetet-dyshojne-per-rrjedhje-gazi-i334120
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:28:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ecc0ee75ff16abc80a4df5d05ff5ced8cc3ce3bcf82f6962e62d3f652de24df
TEKSTI	5110726c45968caff6e699edf66e10087fad203525380c9714d7fcfdacd32739
PAMJA	f7134acb1aa85d3508c60cf283f48951b1c56413121afcbab1fdc362d64b4611

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	57b6305e8f5fd57c4c69994c879a5056b891c90a68919434462526c51bc3b401
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, në **radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/57b6305e8f5fd57c4c69994c879a5056b891c90a68919434462526c51bc3b401

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

10:23 Hetimet/ Shpërthimi që shkaktoi 6 viktima në Athinë, çifti shqiptar në pritje të fëmijës, autoritetet dyshojnë për rrjedhje gazi • 10:18 Integrimi/ Ursula von der Leyen n

AKTUALITET, 29 SEPTEMBER 2026, 10:23

Hetimet/ Shpërthimi që shkaktoi 6 viktima në Athinë, çifti shqiptar në pritje të fëmijës, autoritetet dyshojnë për rrjedhje gazi

tpz.al TPZ



Gjashtë persona humbën jetën pas shpërthimit të fuqishëm që shkatërroi një godinë në rrugën Lysikratous, në zonën e Plakës në Athinë, ndërsa mes viktimave janë edhe tre persona me origjinë shqiptare. Pas përfundimit të operacionit të kërkim-shpëtimit, autoritetet greke vijnë hetimet për të zbardhur rrethanat e sakta që çuan në shpërthimin dhe shembjen e godinës.

Trupat e gjashtë personave që rezultojnë të zhdukur pas ngjarjes u nxorën nga rrënojat nga ekipet e zjarrfikësve dhe forcat speciale të EMAK-ut. Mes viktimave janë Florinda Hoxha dhe bashkëshorti i saj, Ian Alexander Kirkpatrick. Çifti ishte martuar së fundmi dhe ndodhej në Greqi për muajin e mjalit, por qëndrimi i tyre në Athinë u ndërpre në mënyrë tragjike nga shpërthimi që shkatërroi godinën.

Florida Hoxha dhe bashkëshorti i saj Ian Alexander Kirkpatrick Një të njëjtën ndërtës ndodheshin edhe Florin Hoxha, vëllai i Florindës, dhe bashkëshortja e tij, Eris Çani, të cilët gjithashtu humbën jetën. Sipas informacioneve të publikuara nga mediat greke, çifti po qëndronte në të njëjtën godinë dhe Eris Çani ishte në pritje të një fëmije.

Dy viktimat e tjera janë Athina Paparesku dhe Edmond Hingis, 77 vjeç, me origjinë britanike, të cilët banonin në katin e dytë të godinës.

Çfarë e shkaktoi shpërthimin?

Katër ditë pas shpërthimit, hetimet në vendngjarje vazhdojnë ndërsa ekspertët po përpiqen të përcaktojnë se si u krijuan kushtet që çuan në shpërthimin fatal.

Sipas raportimeve të mediave greke, ndër skenarët kryesorë që po shqyrtohet është ai i një rrjedhjeje të gazit natyror nga një pajisje brenda godinës, e cila më pas mund të jetë ndezur nga një shkëndijë.

ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqët e saj

Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitete

Nga Mero Baze


Teje e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)



Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [klike këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super

neumet janë përqendruar veçanërisht në instalimin e gazit në katin e dytë, në pjesën e godines që u shkatërrua nga shpërthimi. Sipas informacionit të transmetuar nga ERT, ekspertët po shqyrtojnë mundësinë që një pajisje të jetë vënë në funksion gjatë natës dhe të ketë shkaktuar një rrjedhje, ndërsa furnizimi me gaz mund të ketë vazhduar deri në orët e mëngjesit.

Në këtë mënyrë, sipas skenarit që po hetohet, gazi mund të jetë grumbulluar brenda një prej ambienteve të godinës deri në krijimin e një përqendrimi të rrezikshëm.

Ekspertët po shqyrtojnë edhe mundësinë që përqendrimi i gazit të ketë arritur rreth 15 për qind, ndërsa një shkëndijë e shkaktuar nga ndezja e një pajisjeje elektrike mund të ketë qenë e mjaftueshme për të shkaktuar shpërthimin.

Një nga elementet që po shqyrtohet në kuadër të këtij skenari është edhe vendi ku u gjet trupi i gruas së moshuar. Sipas raportimeve, ajo u gjet pranë lavamanit të banjës, duke ngritur dyshimin se shpërthimi mund të ketë ndodhur në momentin kur ajo hyri në banjë dhe ndezi dritën.

Trupat e viktimave të tjera u gjetën në ambiente të ndryshme të godinës, përfshirë dhomat dhe shtretërit.

Të hënën, më 28 shtator, ekipe të specializuara kryen një seri kontrollesh për të përcaktuar nëse kishte rrjedhje në rrjetin e gazit. Për testet u përdorën azot dhe manometra, ndërsa kontrolli u përqendrua fillimisht në një tub rreth dy metra të gjatë, i cili lidh furnizimin qendror me matësin e gazit natyror të ndërtesës.

Sipas ERT, matjet nuk zbuluan rrjedhje në këtë pjesë të instalimit.

Ky rezultat i ka orientuar hetimet drejt pjesës së brendshme të godinës dhe veçanërisht drejt instalimit të gazit në katin e dytë, ku ndodheshin një ngrohës uji dhe një kuzhinë.

Ekspertët po kontrollojnë tashmë me imtësi pajisjet dhe instalimet e brendshme, në përpjekje për të përcaktuar nëse një defekt në sistemin e gazit ka shkaktuar rrjedhjen dhe nëse kjo ka qenë më pas shkak i shpërthimit.

imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)





AKTUALITET / 29 September 2026, 10:18

Integrimi/ Ursula von der Leyen nis nesër turin ballkanik, ndalesa e parë Tirana! Presidentja e KE sjell planin e anëtarësimit për 4 shtete

AKTUALITET / 29 September 2026, 10:12

I dënuar me burg për vrasje, arrestohet në Itali 28-vjeçari! Pritet ekstradimi drejt Shqipërisë

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:46

Projektbuxheti/ Nga taksat te pagat, paketa fiskale 2027 në tavolinë, biznesi hap listën e kërkesave

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:40

VIDEO/ Me makinë mbi trotuar duke bërë filmime për TikTok, 60 mijë lekë gjobë shoferit në Berat! I hiqet leja e qarkullimit

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:30

Operacioni/ U kap duke shitur kokainë në një lokal me gje

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:21

Seanca/ Kërkesa e PD për ligjshmërinë e Shkënit si

**Korambë në një lokal me qumësht,
arrestohet 57-vjeçari në Maliq**

**Ngjashmëritë e Shabanit si
Avokat i Popullit, sot
shqyrtimi në Kushtetuese**

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:12

**'Sekretet'/ Arrestimi i ish-
drejtoreshës së SHISH,
Manjani: Nuk kanë faj
institucionet që Vlora Hyseni
u dashurua me dikë**

AKTUALITET / 29 September 2026, 09:05

**Rama në Samitin e Turizmit
në Bruksel, Shqipëria në
vëmendjen europiane**

AKTUALITET / 28 September 2026, 22:20

**Dështon tentativa e hyrjes së
10 shqiptarëve në Angli, po
transportoheshin me një
gomone me motorë të
fuqishëm!**

AKTUALITET / 28 September 2026, 21:55

**"Auditim në SHISH pas arrestit
të Vlora Hysenit", zbardhen
diskutimet e kreut të SPAK
dhe Ramës në Këshillin e
Sigurisë**

AKTUALITET / 28 September 2026, 21:34

**Zjarr pranë banesave në
lagjen "Zinxhira" në
Gjirokastrë**

AKTUALITET / 28 September 2026, 19:57

**Vihet nën kontroll zjarri në
Kreshpan të Fierit,
shoqërohen në komisariat tre
persona**

AKTUALITET / 28 September 2026, 19:51

Shpërthimi i automjetit në

AKTUALITET / 28 September 2026, 19:26

Dita e 121-të e protestës

Elbasan/ Pronarja është
drejtoresha e Shërbimit Social
të Bashkisë, policia në
vendngjarje, hetohen pistat

qytetarët marshojnë drejt
Kryeministritë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.